



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALESI E MADHE  
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1920.prot

Koplik më: 22/07/2024

PROJEKT -VENDIM

Nr \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

PËR

**MIRATIMIN NË PARIM TE DHËNIES ME QIRA/NE PËRDORIM TË SIPERFAQES  
PYJORE/KULLOSORE PREJ 0.7844 HA , NË ZONEN KADASTRALE 3834, NË  
PASURINË ME NR.869 QË SHTRIHET NË NGASTREN/NENGASTREN 107, NË  
NJESINE ADMINISTRATIVE SHKREL NË PRONËSI TË BASHKISË MALËSI E  
MADHE**

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe , në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 pika “e/1”.neni 9 pika 1.2 a, neni 27 pika 5, urdherit të Kryetarit të Bashkisë nr.49 datë 13.05.2024. Ligjin nr. 57/2020 “ Për Pyjet ”, VKM nr.888 dt.27.12.2022 “Per rastet e dhenies ne perdorim dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimet e sipërfaqeve”, Udhëzimi e Ministrisë Të Mjedisit nr.1 dt.09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit ,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” , pika 2 germa a ,pika 7. VKM nr. 559 dt.29.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave për dhënie për shfytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore” ” si dhe bazuar në VKM. Nr.433, datë 08.06.2016 , të Këshillit të Ministrave , “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave të inventarit , dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave /Bashkive ‘’, të ndryshuar.

**VENDOSI:**

Që t'i propozojë Këshillit të Bashkisë Malësi Madhe :

**I – Të miratojë në parim dhënie me qira në favor të tretëve të pasurisë së llojit Pyll trungishte**



a. Siperfaqen pyjore prej 0.7844 ha në zonen kadastrale 3834, me index harte K-34-52-(242-b) në pasurinë me nr.869 që shtrihet në ngastren/nengastren 107, pjese e ekonomise pyjore "Fushe e Zeze" në pronësi të Bashkisë Malësi e Madhe sipas VKM. Nr.433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave /Bashkive", të ndryshuar,

II-Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit, sipas Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1 dt.09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik"

III-Vlera minimale e qirase lekë /ha/vit do të jetë 96 184 (nentedhjetegjashtëmijënjëqindetëdhjetëkater) lekë/vit, llogaritur mbi raportin e studimit tekniko ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Malësi e Madhe për qëllime pushimi, argëtimi, veprimtari turistike, kampingje të hartuar nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve, dhe tarifave të përcaktuara në VKM nr. 559 dt.29.07.2022 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave për dhënien për shfytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore

IV- Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe për vazhdimin e procedurave të metejshme

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETAR  
TOMRIN MARINAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALESI E MADHE  
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1929/prot

Koplik më: 22/07/2024

Relacion  
PËR

**MIRATIMIN NË PARIM TE DHËNIES ME QIRA/NE PËRDORIM TË SIPERFAQES  
PYJORE/KULLOSORE PREJ 0.7844 HA , NË ZONEN KADASTRALE 3834, NË  
PASURINË ME NR.869 QË SHTRIHET NË NGASTREN/NENGASTREN 107, NË  
NJESINE ADMINISTRATIVE SHKREL NË PRONËSI TË BASHKISË MALËSI E  
MADHE**

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 64 germa c .

Të nderuar këshilltarë

Bazuar në kërkesen nr.1297 prot. datë 13.05.2024 e ardhur nga subjekti Emina Çelaj ne formën e propozimit të pakërkuar sipas pikes 7 të Udhëzimit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” , ku kanë kërkuar marrjen me qira të sipërfaqes prej 0.7844 ha për zhvillimin e aktivitetit të tyre , më lejoni tu paraqes relacionin për raportin mbi studimin tekniko ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Malësi e Madhe për qëllime pushimi, argëtimi, veprimtari turistike, kampingje të përgatitur nga Drejtoria e Administrimit Pyjor me nr.1298/2 prot., datë 21.06.2024.

Ky studim tekniko ekonomik ka për objekt llogaritjen e vlerës minimale të qirasë per qellime pushimi ,argetimi, veprimtari turistike , kampingje për ngastrat pyjore. Mbeshtetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor kullor rezulton që sipërfaqja Pyll Trungishte prej 0.7844 ha në ngastrat/nënngastrat nr 107 në ekonominë pyjore“ Fushë e Zezë “ , dhe është në pronësi të Bashkisë Malësi e Madhe .

Sipërfaqja e marrë në studim do ti nënshtrohet procedures së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Sipërfaqja që kërkohet të jepet në përdorim është 0.7844ha.

Në funksion të sipërfaqes që jepet në përdorim , sipas VKM-së nr. 559 dt.29.07.2022 te Këshillit të Ministrave “ Për percaktimin e tarifave për dhënien për shfytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore

4.Për qëllime pushimi argëtimi ,për veprimtari turistike , kampingje ( kënde lodrash , shëndetësore,shoqërore dhe mjedise sportive , shlodhëse, kulturore etj.				
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës leke/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1.	Pyll trungishte	198 000	132 825	110 000

**Vlera minimale e qirasë është 96 184 lekë/vit .**

Procedurat qe ndiqen për dhënie ne përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullisor publik janë te mbështetura ne VKM Nr. 888, datë 27.12.2022 për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre, në Udhëzimin e Ministrit te Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullisor publik”.

Bazuar në sa më sipër , propozojmë miratimin në parim të dhënies me qira/ në përdorim të sipërfaqes prej 0,7844 ha.

Faleminderit për mirëkuptimin!

**KRYETAR**

**TONIN MARINAJ**